



KOMUNA E GJAKOVËS



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2023

Datë: 27.07.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nën nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr 011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2023 pas diskutimit lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës: Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705008-00396-6, e miratoi këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705008-00396-6 së bashku me objektet përcjellëse me këtë përbërje :
 - z. Nikoll Lleshi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
 - z. Gani Hajdari, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 - z. Valon Pnishi, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 - znj. Besarta Lekaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 - znj. Brilanda Ballata, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
- Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
- Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni Vlerësues .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.

Arbëneshë Kruqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës